



Datë: 07.07.2025
Numër Protokolli: 5525/2025

A.nr.985/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.985/2025, të datës 28.05.2025, të parashtruar nga ankuesi B.K, kundër organit të punësimit/Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e jashtë afatshme ankesa me numër A.nr.985/2025, e datës 25.0.2025, e parashtruar nga ankuesi B.K.

A r s y e t i m

Ankuesi B.K (tutje referuar vetëm ankuesi) më datë 28.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me përshkrimin e detyrave të punës të përcaktuar sipas kontratës së punës gjegjësisht pikës 6 dhe 7 të përshkrimit të detyrave të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Kolegji i Këshillit) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 09.06.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3557/2025 të datës 28.05.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Emailin e datës 21.05.2025 nga A.M për H.P; Emailin e datës 14.05.2025 nga D.H për ankuesin; Emailin e datës 29.04.2025 nga ankuesi për D.H; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.06.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 09.06.2025; Kontratës Pune për kohë të caktuar e datës 13.11.2024; Projekt-propozimi për pozitat e nevojshme datës 04.09.2024; Kërkesë për konfirmim të mjeteve buxhetore datës 03.09.2024; Konkursin me Nr. reference RN00015047 për grupin e përgjithshëm të mjedisit pozita Zyrtar Mbështetës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e jashtë fatshme, **për shkak se:**

Nga administrimit i provave të lëndës, del së Komuna e Obiliqit më datë 06.09.2024 ka shpallur konkursin me Nr. Referencës RN00015047 për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit për pozitën Zyrtar Mbështetës për realizimin e një projekti, e ku si rezultat i këtij konkursit, ankuesi ka rezultat kandidat fitues dhe i njëjti më datë 13.11.202, ka nënshkruar Kontratën e punës për kohë të caktuar duke themeluar marrëdhënie pune në pozitën Zyrtar Mbështetës-Projekt në Drejtorinë e Inspektionit, në kuadër të Komunës së Obiliqit për realizimin e një projekti, për një periudhë tri (3) vjeçare gjegjësisht prej datës 11.11.2024 deri më datë 11.11.2027, të cilën kontratë ankuesi e ka nënshkruar pa vërejte.

Tutje, sipas shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi më datë 29.04.2025, i është drejtuar me email Zyrës Ligjore të Komunës së Obiliqit, duke kërkuar që nga pozita që është emëruar a ka të drejtë të bëjë aktvendime pasi që ka konsideruar si pengesë e aspektit të përgatitjes së aktvendimeve dhe vendimmarrjes, ndërsa përfaqësuesja e Zyrës Ligjore e Komunës së Obiliqit më datë 14.05.2025 përmes emailit ka njoftuar ankuesin se duhet t'i drejtohet Zyrës së Personelit si përgjegjëse. Përfaqësuesja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes emailit të datës 21.05.2025, ka sqaruar se kontrata e punës është lidhur me dëshirë dhe vullnet dhe është nënshkruar me pëlqimin e të dy palëve dhe duhet respektuar.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se si pika kontestuarra të konkursit dhe kontratës janë: *Aplikon fletëparaqitje penale dhe kundërvajtëse, kur vlerëson se ka shkelje të dispozitave kundërvajtëse dhe penale dhe Jep pëlqime për eksploatim të resurseve natyrore, lejet ujore dhe mjedisore simbas dispozitave ligjore*, duke pretenduar se këto përshkrime janë detyra të Inspektorit të Ministrisë së Mjedisit. MPHI-së. Kërkon që ankesa të pranohet.

Kolegji i Këshillit në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore iu referuar dispozitave të nenit 37 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më të cilin shprehimisht thuhet se: *1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj. 3. Përfundimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 3.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme. 4. Kontrata e punës për periudhë të caktuar sipas paragrafit 3. të këtij neni, lidhet për aq sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.1. të këtij neni dhe jo më të gjatë se dy (2) vite për kontratën sipas nën-paragrafit 3.2. të këtij neni. 5. E/i punësuar/i me kontratë sipas paragrafit 3. të këtij neni, gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit civil, me përjashtim të së drejtës për vazhdim të kontratës së përkohshme, pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit.*

Ndërsa, në kuptim të pranushmërsisë së ankesës, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme*

Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1, ku përcaktohet se: *1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi, me datë është e pasafatshme, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, ankuesi më datë 13.11.2024, kishte nënshkruar pa asnjë vërejtje kontratën e punës për pozitën përkatëse, ndërsa, i njëjti me datë 11.07.2025 parashtron ankesë në Këshill duke kundërshtuar detyrat e punës sipas pikën 1 dhe 6 të nenit 3 të Kontratës së punës, kështu që, mbi këtë bazë, ankesa është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.985/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.K;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.